




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës Jugore
Opstina J.Mitrovica – Municipality of S. Mitrovica



Politikat e Privatësisë në Komunën e Mitrovicës së Jugut

Gusht 2025

HYRJE

Në përmbushje të detyrave, përgjegjësi dhe në ushtrim të funksioneve të saj, Komuna e Mitrovicës së Jugut është e përkushtuar që të mbroj interesin e ligjshëm të qytetarëve të saj përfshirë privatësinë dhe të dhënat personale të tyre, ashtu siç janë të garantuar me Kushtetutë dhe legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.

Ky dokument paraqet angazhimin e Komunës së Mitrovicës së Jugut që në përputhje me legjislacionin relevant e në veçanti Ligji nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale si dhe standardet e Bashkimit Evropian të mbroj privatësinë dhe të dhënat personale të qytetarëve. Përveç kësaj, komuna synon të informojë qytetarët se si mblidhen, përpunohen, ruhen dhe mbrohen të dhënat e tyre gjatë ofrimit të shërbimeve komunale.

Përmes këtyre politikave, ne synojmë të sigurojmë transparence të plotë, llogaridhënie dhe besim, duke siguruar që të dhënat personale përdoren vetëm për qëllime të ligjshme dhe në konsiderat të plotë për privatësinë.

Qytetarët duhet të jenë të informuar për proceset tona dhe të ushtrojnë të drejtat e tyre, përfshirë qasjen, korrigjimin ose fshirjen e të dhënave të tyre si dhe mundësinë për të adresuar çdo rast te Zyrtari për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Komunën e Mitrovicës së Jugut ose në Agjencinë për Informim dhe Privatësi.

Përfundimisht Komuna e Mitrovicës së Jugut pasqyron angazhimin e saj për të ndërtuar një mjedis të sigurt dhe të besueshëm për të gjithë banorët e saj.

Përmbajtja:

- **Politika e Privatësisë**
- **Kush i përpunon dhe është përgjegjës për të dhënat tuaja personale?**
- **Kategoria e të dhënave që përpunojmë?**
- **Për çfarë qëllimesh i përdorim të dhënat tuaja personale?**
- **Baza ligjore për përpunim**
- **Me kë i ndajmë të dhënat personale të mbledhura?**
- **Cilat janë të drejtat tuaja?**
- **E drejta e ankimit**
- **Siguria e të dhënave personale**
- **Përditësimi i Politikës së Privatësisë**

Politika e Privatësisë

E drejta e privatësisë dhe mbrojtja e të dhënave tuaja personale është prioritet kryesor i Komunës të Mitrovicës së Jugut, e cila angazhohet të përpunojë të dhënat tuaja personale me përgjegjësi dhe në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, dhe në pajtim me legjislacionin evropian për mbrojtjen e të dhënave personale.

Kjo politikë e mbrojtjes së të dhënave personale është e zbatueshme nëse jeni aplikant për punë, palë kontraktuese, merrni pjesë në një trajnim të organizuar nga ne, vizitoni komunën, përdorni ndonjë shërbim, paraqisni kërkesë përmes email-it apo faqës tonë të internetit: <https://mitroviceejugut.rks-gov.net>.

Kush i përpunon dhe është përgjegjës për të dhënat tuaja personale?

Përpunues i të dhënave personale është Komuna e Mitrovicës, me adresë rruga “Bedri Gjinaj” 40000 Mitrovicë.

Zyrtari përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale është Bedri Muja, email adresa: bedri.muja@rks-gov.net, tel: 044 532 873.

Kategoria e të dhënave që përpunojmë?

Në varësi të qëllimeve dhe arsyeve specifike, Komuna e Mitrovicës së Jugut përpunon të gjitha ose disa nga të dhënat personale të specifikuara më poshtë, ndaras ose në kombinim midis tyre:

Të dhënat e identifikimit: emri, mbiemri, të dhënat e dokumentit të identitetit;

Të dhënat e kontaktit: adresa, email, numri i telefonit;

Të dhëna për arsimin, shëndetin, kualifikimin profesional dhe veprimtarinë e punës;

Të dhëna të tjera të kërkuara sipas ligjeve të veçanta që rregullojnë marrëdhëniet e punës ose marrëdhëniet kontraktuale;

Informacione të tjera dhe të dhëna personale të nevojshme për përmbushjen e detyrimeve statutorë për të garantuar sigurinë në ofrimin e shërbimeve të navigacionit ajror;

Foto dhe video nga konferenca apo ngjarje;

Për çfarë qëllimesh i përdorim të dhënat tuaja personale?

Përmbushja e detyrimeve ligjore të percaktuara me Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, legjislacionin në fuqi të Bashkimit Evropian për mbrojtjen e të dhënave personale.

Përmbushja e urdhrave të organeve kompetente shtetërore;

Përzgjedhja e punonjësve, duke përfshirë kryerjen e trajnimeve të specializuara dhe gjuhësore për rekrutimet te reja;

Lidhja e kontratave dhe marrëdhënieve parakontraktuale;

Garantimi i sigurisë së punonjësve, vizitorëve, si dhe infrastrukturës së ndërmarrjes, përmes sistemit të mbikëqyrjes video, sigurisë fizike, kontrollit të qasjes dhe regjistrimit të vizitorëve të jashtëm;

Sigurimi i funksionimit normal, mirëmbajtjes dhe sigurisë së faqes së internetit dhe sistemeve të informacionit dhe komunikimit të brendshëm;

Organizimi dhe realizimi i trajnimeve të specializuara nga Organizata Trajnuese në komunë;

Përpunimi i kërkesave sipas Ligjit NR. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike;

Promovimi i aktiviteteve të komunës konform dispozitave të Ligjit nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si: shpërndarja e materialeve dhe broshurave reklamuese, postimin e fotove / videove në web faqe, Facebook, Instagram, Twitter, LinkedIn ose në media tjera.

Baza ligjore për përpunim

Komuna e Mitrovicës së Jugut përpunon të dhënat personale të subjekteve bazuar në interesin e tyre subjektiv si dhe në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, dhe në pajtim me legjislacionin evropian për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në disa raste, ne përpunojmë të dhënat personale vetëm pas pëlqimit paraprak të subjektit të të dhënave. Pëlqimi i dhënë mund të tërhiqet në çdo kohë nga subjekti.

Me kë i ndajmë të dhënat personale të mbledhura?

Autoritetet kompetente siç janë ato të sigurisë, gjyqësore dhe mbikëqyrëse, që në bazë të një akti juridik kanë autoritetin të kërkojnë nga komuna të dhënat personale për subjektet e caktuara.

Cilat janë të drejtat tuaja?

Kur të dhënat tuaja personale përpunohen nga zyrtarët përgjegjës në Komunën e Mitrovicës së Jugut, ju keni të drejtë:

- të qasjes në të dhënat tuaja dhe në çdo kohë, të kërkonit t'i korrigjoni dhe përditësoni pa vonesë nëse të dhënat tuaja janë të pasakta ose jo të plota;
- të fshirjes (të drejta për t'u harruar) së të dhënave tuaja dhe mund të kërkonit që përpunimi të ndalohet në rrethana të caktuara;
- të kërkonit që ndonjë nga ndryshimet e mësipërme t'u komunikohet palëve të tjera, të cilave u janë zbuluar të dhënat tuaja;
- të ankoheni në çdo kohë nëse besoni se të drejtat tuaja për mbrojtjen e të dhënave janë shkelur.

E drejta e ankimimit

Në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, çdo person fizik që beson se i është shkelur e drejta për mbrojtjen e të dhënave personale, mund të paraqesë ankesë pranë Komunës së Mitrovicës së Jugut, me adresë rruga: "Bedri Gjinaj" në Mitrovicë, në email adresë bedri.muja@rks-gov.net, si dhe pranë Agjencisë për Informim dhe Privatësi me adresë: Rr. Zejnel Salihu - Nr.22, 10000, Prishtinë, Republika e Kosovës (dhe në email adresën info.aip@rks-gov.net).

Siguria e të dhënave personale

Komuna e Mitrovicës së Jugut zbaton masat e duhura fizike, organizative dhe teknike për të mbrojtur të dhënat tuaja personale në pajtim me dispozitat përkatëse të Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Kohëzgjatja e ruajtjes së të dhënave personale varet nga qëllimet e përpunimit për të cilat ato janë mbledhur dhe është e rregulluar me Ligjin përkatës për Arkivat Shtetërore ose me ndonjë ligj tjetër përkatës.

Përditësimi i Politikës së Privatësisë

Ne mund të përditësojmë herë pas here politikën tonë të privatësisë dhe do t'ju njoftojmë për çdo ndryshim duke postuar politikën e re të privatësisë në këtë faqe.

Faqja e internetit mund të përmbajë linqe të ndryshme të faqeve të tjera të internetit, për të cilat ju rekomandojmë të i lexoni politikat e privatësisë të faqeve të tyre.

Mitrovicë




Bedri Muja – Zyrtar i Lartë Ligjor



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Kryetari i Komunës

Nr. 01/12/02-0044929/25 dt. 30.07.2025
Mitrovicë

Bazuar në nenet 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenet 14 dhe 77 të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, dhe nenin 37, 38 dhe 39 të Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Kërkesën Elektronike të dt. 21.07.2025 nga Agjencia për Informim dhe Privatësi (AIP), dhe Kërkesën Elektronike të dt. 25.07.2025 nga Shefi i Kabinetit të Kryetarit z. Valon Hetemi Kryetari i Komunës, sjell këtë:

V E N D I M

(Për emërimin e Zyrtarit/es për Mbrojtjen e të Dhënave Personale)

1. Emërohet Zyrtari i lartë ligjor z. Bedri Muja, Zyrtar për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për Komunën e Mitrovicës Jugore.
2. Zyrtari i emëruar sipas pikës 1 (një) të këtij Vendimi bazë për punën e tij do të ketë Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale si dhe aktet ligjore dhe nënligjore nga fusha përkaëse.
3. Zyrtari për Mbrojtjen e të Dhënave obligohet që ti raportoj Kryetarit të Komunës në përputhje me dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi.
4. Mandati i Zyrtarit të emëruar është 2 (dy) vjeçar.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Kryetari i Komunës

Bedri HAMZA

Shtojcë:

1x1 Kërkesa Nr 02/682, dt. 14.09.2023 nga Agjencia për Informim dhe Privatësi (AIP) për caktimin e Zyrtarit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe hartimin e Politikave të Privatësisë;

1x1 Kërkesa Elektronike nga Agjencia për Informim dhe Privatësi (AIP) dt. 21.07.2025;

1x1 E-mail-i i Shefit të Kabinetit të Kryetarit z. Valon Hetemi i datës 25.07.2025.

Ti dorëzohet:

- 1x1 Kryetarit të Komunës
- 1x1 Zyres Ligjore
- 1x1 Zyres për Informim
- 1x1 z. Bedri Muja
- 1x1 Arkivit